



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

KOMITETI PER POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal-Junik
Nr. 02-02-23
Datë: 21. 02. 2023, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Komitetit për Politike dhe Financa në Junik, të mbajtur më datë 21 Shkurt, 2023, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Shpejtim Gacaferi, kryesues (LDK),
2. Ermelinda Lolluni, përfaqësuese (LDK),
3. Rajmonda Krasniqi, përfaqësuese (AAK),
4. Xhemë Tofaj, përfaqësues (LVV), dhe
5. Dervish Bajraktari, përfaqësues (AAK).

Poashtu të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i Komunës z. Ruzhdi Shehu, Nënkryetari Komunës, z. Besart Tofaj, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znjsh. Vjollca Qestaj, Drejtori për Arsim z. Xhavit Velijaj, Drejtori për Shërbime Publike z. Demokrat Ganiqaj, dhe Zyrtari Kryesor Financiar z. Arten Hamza.

Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Komitetit për Politike dhe Financa e shpalli të hapur kryesuesi i këtij Komiteti, z. Shpejtim Gacaferi, ndërsa tha, e cekë se nga pesë anëtarë të KPF-së të gjithë jemi të pranishëm në këtë mbledhje.

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi kërkoj miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi Planin e Ekzekutivit për vitin 2023,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022,
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026,
5. Informatë rreth suksesit të nxënësve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët dhe Shkollës së Mesme 'Kuvendi i Junikut', rreth përgatitjeve për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim /DSHPIMSH/ për formimin e komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut, dhe
7. Të ndryshme.

Pika e Parë

Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Ky procesverbal u shqyrtuan dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratuan nga anëtarët e KPF-së.

Pika e Dytë

Informatë e Kryetarit të Komunës mbi Planin e Ekzekutivit për vitin 2023,

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, ky material ka disa ndryshime të cilat do t'i shpjegoj drejtoresha.

Znjsh. Vjollca Qestaj tha, ky plan përshinë krejt programet buxhetore të Komunës së Junikut, nga zyra e Kryetarit deri te Zyra komunale për Komunitete. Përveç një gabim teknik që ka ndodh na këtë plan është i përfshirë dhe Plani i Punës i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, që në mbledhjen e Kuvendit besoj që vjen i kompletuar me shtojcat tjera. Ky plan është bërë publik më herët, mirëpo do të publikohet edhe web-faqen e Komunës.

Z Xhavit Velijaj tha, te pjesa e arsimit në këtë plan do të bëhen plotësime nga zyrtari përkatës i arsimit.

Pika e Tretë

Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022

Z. Besart Tofaj tha, edhe ky Raport është në planin e hershëm për vitin 2022, që parasheh aktivitetet ku kanë qenë 25 aktivitete, ku një pjesë e madhe e tyre është realizuar, por ka edhe aktivitete me shumë më të vogla që janë realizuar, dhe jemi munduar ta përfillim planin e brendshëm të punës për vitin 2022. Por ka edhe aktivitete që nuk kemi arritur t'i

realizojmë. Ndër to është edhe obligimi i QKMF-së për funksionim 24 orë. Pra, kjo mbetet të bëhet në planin e brendshëm që do të përpiqemi që ta bëjmë. Nga të hyrat kapitale, mallra dhe shërbime i kemi diskutuar shpenzimet për secilën kategori në raportin e Buxhetit të muajit të kaluar, dhe në kuadër të atij plani kemi aktivitetet e realizuara.

Pika e Katërt

Shqyrtimi i Draft-Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026

Z. Shpejtim Gacaferi tha, komunat janë të obliguara që ta kanë Planin e Veprimit për Transparencë, i cili përgatitet në afat kohor prej 4 viteve. Për këtë vit Kryetari ka përgatitur një Draft-Plan për Transparencë, i cili ka afate ligjor deri në vitin 2026. Ne do të konsultohemi nëse ky Plan i Veprimit duhet të dalë në Dëgjim Publik, apo jo, dhe nëse jo nuk ka nevojë që të kalon në Kuvend, dhe mbetet vetëm si informatë për neve.

Z. Rrustem Pepshi tha, ky plan ka ardhur nga Asociacioni i Komunave në bashkëpunim me MAPL-në. Këtë Draft-Plan ne duhet ta përshtatim me objektivat tona, por ky është një plan standard për të gjitha komunat, që ka të bëjë me informatat, publikimet e ndryshme në web-faqe, dëgjime dhe takime publike. Kështu që nuk ka ndonjë ndryshim që duhet të bëhet. Ne do ta qesim në Kuvend, mirëpo është Komisioni që e ndryshon këtë plan, i cili mundet të përshtatet në bazë të nevojave të Komunës. Për këtë arsye disa komuna e kanë qitur në dëgjim publik, e disa tjera jo. Por ne mundemi të konsultohemi prapë, por unë nuk mendoj që ka nevojë të ndryshohet diçka në të.

Pika e Pestë

Informatë rreth suksesit të nxënësve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët dhe Shkollës së Mesme 'Kuvendi i Junikut' rreth përgatitjeve për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë

Z. Xhavit Velijaj tha, sa i përket suksesit të gjysmëvjetorit të parë dhe fillimit të gjysmëvjetorit të dytë, sukseksi i vitit shkollor 2022/2023, për ne si institucion edukativo-arsimor në Komunën e Junikut ky vit ka qenë sfidues, për shkak se ka filluar një muaj me vonesë dhe për shkak të grevës në arsim, dhe sigurisht kjo ka reflektuar edhe të procesi arsimor për gjysmëvjetorin e parë.

MASHT-i pos grevës ka dalë me një vendim dhe me ndryshim të kalendarit, ku është paraparë plotësim i mësimit ditëve të shtuna, në mënyrë që orët e humbura të kompensohen. Mirëpo, kjo nuk është bërë në shkollat e Komunës sonë, për të cilën gjë nuk ka qenë vullneti, dhe kjo ka reflektuar të procesi mësimor dhe sukseksi në mësim. Këtu kemi të bashkangjitur te shtojcat; Shkolla Filllore niveli 1-5, klasa e parë ka 3 paralele, me 37 nxënës, klasa e dytë ka 3 paralele me 40 nxënës, klasa e tretë ka 3 paralele me 61 nxënës, klasa e katërt ka 3 paralele me 45 nxënës, dhe klasa e pestë poashtu 3 paralele me 64 nxënës. Pra, të gjitha klasët kanë gjithsej 247 nxënës. Sukseksi është pozitiv, dhe nota mesatare nga klasa e parë deri në të pestën është 4.22. Mesatarja e mungesave për nxënës është 3.28.

Te tabela e dytë kemi nivelin e arsimit të mesëm të ulët, pra klasët nga e gjashta deri te e nënta.

Klasa e gjashtë ka 3 paralele me 54 nxënës, klasa e shtatë ka 3 paralele me 43 nxënës, klasa e tetë ka 3 paralele me 60 nxënës dhe klasa e nëntë po ashtu ka 3 paralele me 51 nxënës.

Nota mesatare për klasët gjashtë deri në nëntë është 3.48, ndërsa mungesa mesatare për nxënës është 4.65.

Te niveli i arsimit të mesëm të lartë apo gjimnazi 'Kuvendi i Junikut' kemi klasën e dhjetë me 3 paralele që ka 58 nxënës, klasën e njëmbëdhjetë me 3 paralele me 57 nxënës, dhe klasën e dymbëdhjetë me 3 paralele poashtu me 51 nxënës. Pra, gjithsej 166 nxënës në gjimnazin 'Kuvendi i Junikut'.

Këtu kemi notën mesatare 2.62. Këtu ka ndikuar problemi pandemisë në vitin e kaluar, ndërsa këtë vit ka ndikuar greva në arsim, që ka reflektuar në këtë sukses.

Pra, ky është rezultati. Ne kemi bërë përpjekje vazhdimisht që të ngritët rezultati dhe aktiviteti.

Për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë që ka filluar me 6 Shkurt, 2023 kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme.

Pika e Gjashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim /DSHPIMSH/ për formimin e komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut

Z. Shpejtim Gacaferi tha, ne në Kuvend më datën 27 Janar, 2023 kemi nxjerr një vendim për fillimin e procedurave për trajtimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut. Tani kërkohet që të formohet komisioni i cili do të punoj me Draft-Rregulloren.

Ne kemi një kërkesë nga drejtori i drejtorisë përkatëse, ku është paraparë përbërja e këtij Komisioni, të cilin e përbëjnë; z. Demokrat Ganiqaj-kryesues, z. Rustem Pepshi, z. Arian Xhuli, z. Turim Ganiqaj, z. Ali Gacaferi, znjsh. Vjollca Qestaj, z. Idriz Gacaferi, dhe znj. Valbona Gaxherri-Gacaferi- anëtarë, ndërsa kanë mbetur edhe tre anëtarë që të zgjidhen si përfaqësues të subjekteve politike të Kuvendit. Dhe, nëse jemi të gatshëm që sot mund t'i caktojmë edhe anëtarët nga Kuvendi, nëse jo, atëherë ne mundemi ta kalojmë këtë pjesë, ose të votojmë sot por me kusht që në Kuvend ky Komision të kompletohet edhe me tre emra.

Anëtarët e KPF-së u pajtuan që këta anëtarë të propozohen në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Z. Demokrat Ganiqaj tha, unë kam një kërkesë që kur të bëhet propozimi nga partitë në Kuvend, mundësisht këta kandidatë të jenë profesioniste, pra të jenë ata që mund ta japin kontribut.

Z. Xhavit Velijaj tha, edhe unë të njëjtën gjë e kam kërkuar edhe më herët për komisionet tjera dhe grupet punuese, pra që të shfrytëzojnë aftësitë profesionale në fusha të caktuara, ndërsa propozoj që t'i jepet mundësi ekzekutivit për përzgjedhje e këtyre kandidatëve.

Me këtë nuk u pajtuan z. Xhemë Tofaj dhe Dervish Bajraktari të cilët thanë se këto janë paragjykime dhe si të tilla janë të papranueshme.

Z. Xhemë Tofaj tha, ne mund t'i propozojmë dhe përzgjedhin cilëndo kandidatë për grupe punuese dhe komisione brenda subjekteve tona politike.

Z. Demokrat Ganiqaj tha, unë vetëm po kërkoj që këto grupe punuese ta japin kontributin e tyre.

Pika e Shtatë Të ndryshme

Znj. Rajmonda Krasniqi pyeti për mungesën e furnizimit me dru në shkolla.

Z. Xhavit Velijaj tha, kjo është mungesë sepse vitin e kaluar ka qenë kriza e energjisë, dhe lëvizja e çmimeve, që ka ndikuar në numrin e vogël të kërkesës për m³ me dru për djegie. Ne nuk kemi mundur t'i marrim ato që kishim parashikuar për shkak të buxhetit. Unë kam planifikuar që këtë muaj të bëhet furnizimi. Tani janë kryer të gjitha procedurat dhe furnizimi do të bëhet shumë shpejtë, pra brenda ditësh.

Me kaq, kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi e shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KPF-së.

Gëzim Geci-Procesmbajtës

Shpejtim Gacaferi-Kryesues